

NJOFTIM PUNE

Profil i kompanisë: Balkan Finance Investment Group është një ndër grupet private investuese më të mëdha në Shqipëri dhe rajon, i pranishëm me aktivitete për zhvillimin e pasurive të paluajtshme, shitjet me pakicë, ofrimin e shërbimeve dhe manaxhimin e hapësirave tregtare apo industriale, telekomunikacion, industria minerare, financime dhe programe besimi për konsumatorët. SPAR Albania është pjesë e Balfin Group dhe drejton rrjetin më të madh të shitjeve ushqimore me pakicë me të drejtën e ekskluzivitetit të emrit "SPAR".

Pozicioni: Specialist i Marketingut Dixhital

Departamenti: i Marketingut

Vendodhja: Zyra Qëndrore

Përmbledhja e Pozicionit: Ne po kërkojmë një person me eksperiencë, kreativ, inovator dhe të apasionuar pas marketingut dixhital, që të zhvillojë më tej komunikimin online të Spar Albania. Të zhvillojë përmbajtjen, të krijojë dhe të ndjekë strategjinë e marketingut dixhital të kompanisë.

Detyra dhe Përgjegjësi:

- Ndërton dhe ndjek strategjinë e komunikimit dixhital të kompanisë, sipas strategjisë së marketingut si dhe duke ndjekur politikën e brandit Spar;
- Identifikon platformat inovative të cilat ndihmojnë zhvillimin e komunikimit online të kompanisë sipas strategjisë së përcaktuar;
- Identifikon potenciale dhe krijon marrëdhënie me partnerë të medias dixhitale;
- Identifikon potencialet për të ndërtuar komunikime të ndryshme dhe të drejtpërdrejta nëpërmjet marketimit dixhital;
- Harton planin e detajuar për median sociale duke përfshirë përmbajtjen dhe imazhet e komunikimit;
- Kujdeset për mirëmbajtjen vizuale dhe përmbajtjen e informacionit të Web-it Spar.al;
- Krijon fushata të ndryshme për të suportuar strategjinë e marketingut dhe për të forcuar prezencën e Spar-it në komunikimin online;
- Kujdeset që imazhi i brandit Spar të komunikohet masivisht dhe në mënyrë korrekte në marketingun dixhital;
- Kujdeset që çdo fushatë, promocion, event, etj, të marrë vëmendjen maksimale në marketingun dixhital;
- Ndjek dhe kontrollon konkurrencën në komunikime online;
- Ndjek, ndihmon dhe kujdeset që strategjia e marketingut të zhvillohet në të gjitha format e komunikimit duke dhënë rezultate të larta;
- Kujdeset për imazhin e kompanisë vizualisht duke vendosur një standard të lartë komunikimi;
- Kujdeset për çdo komunikim të kompanisë duke krijuar përmbajtjen e saktë të tekstit dhe/ose imazheve;
- Kujdeset që tu përmbahet buxheteve të përcaktuara nga të cilat të arrihet komunikimi maksimal në median dixhitale;

Kërkesat:

Edukimi: Të zotërojë diplomë universitare.

Eksperiencat e punës: Të ketë eksperiencë pune në profile të ngjashme;

Kualifikime të tjera:

- Njohuri shumë të mira të gjuhës Angleze;
- Njohuri shumë të mira kompjuterike;
- Njohuri shumë të mira mbi komunikimin online;
- Njohuri shumë të mira në kërkime dhe hulumtime;
- Njohuri shumë të mira mbi zhvillimet më të fundit të teknologjisë së komunikimit dixhital;

Kompetenca personale:

- Të zotërojë aftësi të mira komunikuese;
- Dëshirë për bashkëpunim dhe ndërveprim;
- Të jetë person kreativ;
- Të jetë i/e organizuar dhe të menaxhojë kohën;
- Të ketë dëshirë për tu njohur me të rejtat më të fundit në fushën e komunikimit online;

Kushtet e punës: Ofrohet pagë konkurruese.

Mënyra e aplikimit*: Kandidatët e interesuar janë të lutur të dërgojnë CV e tyre së bashku me letër motivimi në adresën e e-mailit hr@spar.al duke përcaktuar në subjekt pozicionin, online nëpërmjet faqes së Web-it Spar.al, ose nëpërmjet postës në adresën: SPAR Tirana East Gate (TEG), Rruga Nacionale Tiranë-Elbasan, Farkë (Lundër), Tiranë, Shqipëri.

Afati i dorëzimit: 11.09.2020

*Të gjitha aplikimet do të trajtohen me konfidencialitet të plotë sipas ligjit Nr .9887 vendosur nga Kuvendi i Shqipërisë për “Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.